



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 128 prot.

Kamëz, më 04.09.2022

V E N D I M

Nr. 109 Datë 04.09 2022

MBI

**“MIRATIMIN E SHEMBJES SË “QENDRËS SHËNDETËSORE” NDODHUR NË ADRESËN; RRUGA “BESNIK HIDRI” ZALL MNER, SI REZULTAT I DËMTIMIT NGA TËRMETI I DATËS 26.11.2019”.**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 07.09.2022, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.98 Datë 07.09.2022, në mbështetje të neni 113, pika 2, të Kushtetutës; Nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1 nënpika 1.1 shkronja “b”, nenit 29 pika 1, nenit 54 shkronja “e”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar; Nenit 42, pika 1, shkronjat “b” dhe “d”, nenit 57 nenit 58, të Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”; Ligji nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”; Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”; Vendimit nr.165, datë 19.02.2020 të Këshillit të Ministrave “Për caktimin e njëjësive zbatuese për projektimin, rindërtimin dhe rikonstruksionin e objekteve arsimore”; Vendimit nr.26, datë 15.01.2020 të Këshillit të Ministrave “Për kryerjen e akt-ekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara nga tërmeti”; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 481, datë 30.05.2013 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, të Qarkut Tiranë”; Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 05.09.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike e shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Kamëz, të Qarkut Tiranë”; si dhe referuar Akt-ekspertizës së dërguar nga Instituti i Ndërtimit me anë të shkresës nr.552/5 prot. datë 06.05.2021, protokolluar pranë Bashkisë Kamëz me nr.4822 datë 11.05.2021, **Këshilli Bashkiak Kamëz**;

V E N D O S I:

1. Miratimin e shembjes së “*Qendrës Shëndetësore*” Zall-Mner sipas akt-ekspertizës së thelluar të Institutit të Ndërtimit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit merr të gjitha masat për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Policia Bashkiake mbështet Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit për ndërhyrjen dhe prishjen e objektit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ**

4. Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, njofton 24 orë përpara ndërhyrjes për shembjen e objektit, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë. Ndërhyrja për shembjen e objektit bëhet në prani të përfaqësuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Policisë së Shtetit.
5. Për ushtrimin e përgjegjësisë dhe detyrave të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit të kërkojë asistencën dhe bashkëpunimin e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.
6. Kryetari i Bashkisë i propozon Këshillit Bashkiak miratimin e këtij vendimi dhe ngarkon për zbatimin e tij, Drejtorinë e Rindërtimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Punëve Publike, Drejtorinë e Çështjeve Ligjore, Inspektoriatin e Mbrojtjes së Territorit, Drejtorinë e Financës dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
7. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

**KRYETAR KËSHILLI**

**Hysen KOLDASHI**

